

REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41/2019 (JR)
Nr. 41/4 regj.

Tiranë, më 19.01.2021

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 19.01.2021, *trupi gjykues gjatë shqyrtimit të çështjes mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 51/1 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi të kalojë për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, pasi çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.*

Seanca gjyqësore publike për shqyrtimin e çështjes me numër regjistri (JR) 41/2019, datë 06.09.2019, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 171, datë 26.06.2019, do të zhvillohet më datë **02.02.2021, ora 10.00** në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relatore e Çështjes
Gjyqtar
Gjyqtare
Gjyqtar

Natasha Mulaj
Albana Shtylla
Ardian Hajdari
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

NATASHA MULAJ



